

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI**

### **I**

### **SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

### **ME SELI NË TIRANË**

### **“TIMAC” SHPK**

Sot me datë 05.05.2020 unë e nënshkruara:

Z. Izmir Hoxha, i biri e Nazmiut, lindur në Valikardhë, më datë 25.09.1997, mbajtës i letërnjoftimit me nr. J70925005B dhe banues në Tiranë shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti të Shoqërisë “TIMAC” shpk si më poshtë vijon:

#### **Neni 1**

#### **KRIJIMI**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **TIMAC SHPK** (më poshtë e quajtur “Shoqëria”)

#### **Neni 2**

#### **THEMELIMI**

Shoqëria fiton personalitet juridik pas rregjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, Shqipëri.

#### **Neni 3**

#### **SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. 3 Dëshmorët, Pall. Lorena shpk, Kat. 1.Tiranë.

Shoqëria mund të hap dhe të mbaj zyra dhe/ose të kryej veprimtari biznesi në vende të tjera, qoftë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperisë. Administratori që emërohet nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë Z. Izmir Hoxha mund të vendos për të lidhur kontrata qiraje për zyrën

e rregjistruar dhe/ose të ndryshoj selinë e regjistruar të Shoqërisë dhe të paraqes vendimin përkatës pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

#### Neni 4 OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është të ndërrmar çdo veprim ose aktivitet tregtar të ligjshëm për zhvillimin e të cilave një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të themelohet edhe regjistrohet sipas legjislacionit shqiptar i ndryshuar rast pas rasti duke përfshirë por pa u kufizuar në veprimtarinë e shoqërisë:

- Prodhim, konvertim dhe montim i kostruksioneve metalike e plastike të mjeteve të ndrvshme, si zjarrfikëse, autoambulance, cisterna uji, fshirëse rrugësh, kamion për pastrim, autoblindues, makinë për mirëmbajtje dimërore, kripëhedhëse, makinë për kanalizime e ujëra të zeza dhe mejete të tjera të ngjashme.
- Shitje dhe blerje të makinerive dhe pajisjeve hidraulike, pneumatike, mjekësore etj.

#### Neni 5 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë “Timac” shpk është i përbërë nga një kuote e barazvlefshme me 100.000 (njeqind mijë) Lekë e zotëruar nga Ortaku i Vetem si me poshtë:

- Z. Izmir Hoxha, i biri e Nazmiut, lindur në Valikardhë, më datë 25.09.1997, mbajtës i letërnjoftimit me nr. J70925005B zotërues i 1 (një) kuote e barazvlefshme me 100.000 (njëqind mijë) Lekë ose 100% e kapitalit te Shoqërisë.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortaku i vetëm.

Kuotat e kapitalit janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në perputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar.

Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

**Neni 6**  
**KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit për një periudhë kohore të pacaktuar duke filluar nga data e rregjistrimit të saj në rregjistrin tregtar.

**Neni 7**  
**ORTAKU I VETËM**

Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- Z. Izmir Hoxha, i biri e Nazmiut, lindur në Valikardhë, më datë 25.09.1997, mbajtës i letërnjoftimit me nr. J70925005B zotëruese i 1(një) kuote e barazvlefshme me 100.000 (njëqind mijë) Lekë ose 100% e kapitalit te Shoqërisë (më poshtë i quajtur “**Ortaku i Vetëm**”).

Ortaku i vetëm ushtron kompetencat që Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar i jep Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 8**  
**DREJTAMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria drejtohet nga një apo më shumë Administratore.

Administratori i parë i shoqërisë “**Timac**” shpk është Znj. Manjola Kasneci, shtetase shqiptare, lindur në Tepelenë, më datë 24.03.1984, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. I45324058U.

Administratori emërohet me vendim të Ortakut të vetëm për një periudhë 5 vjeçare.

Shoqëria përfaqësohet pranë çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrdhënie me të tretët nga administratori i cili ushtron keto të drejta në përputhje me statutin e shoqerisë dhe legjislacionin në fuqi.

**Neni 9**

## **SHPËRBËRJA DHE LIKUJDIMI**

Shpërbërja dhe likujdimi i shoqërisë tregtare mund të kryhet në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm dhe në përputhje me legjislacioni shqiptar dhe veçanërisht ne përputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

### **ORTAKU**

**IZMIR HOXHA**

